VENDIM
Nr. 130, datë 27.6.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 112, DATË 23.5.2025, "MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE RREGULLATORE PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të neneve 17, pika 4 dhe 20, germa "d", 45 dhe 46, 51, pika 2, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 14 dhe 30, pika 3, nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të nenit 6, pika 6.3, të "Rregullores mbi përcaktimin e pagesave rregullatorë", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, me nr. 1750/1 prot., datë 25.6.2025, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, 'Mbi llogaritjen e pagesave rregullatorë për vitin 2025'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 112, datë 23.5.2025, ka miratuar përllogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025, për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Pas miratimit të këtij vendimi, në procesin e rishikimit të të dhënave të licencimit dhe të aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit 2024 nga subjektet e licencuara, u konstatua se subjekti "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., edhe pse zotëron licencë aktive në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nuk është përfshirë në listën e përllogaritjes së pagesave rregullatore për vitin 2025.

- Nga të dhënat e raportuara dhe verifikuara nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, rezulton se gjatë vitit 2024 ky subjekt nuk ka ushtruar aktivitet tregtar në veprimtarinë e licencuar. Në përputhje me nenin 6, pika 6.3, të "Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, për subjektet që nuk kanë realizuar aktivitet gjatë vitit ushtrimor, aplikohet një pagesë rregullatore fikse në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë.

- Përfshirja e subjektit "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k. në përllogaritjen e pagesave rregullatorë, për vitin 2025, kërkon ndërhyrje në tabelën nr. IV, të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, si dhe sjell domosdoshmërinë e ndryshimit të përmbajtjes së pikës 2 të po këtij vendimi, vetëm për qëllime të trajtimit të diferencave që rrjedhin nga ky përditësim.

- Pagesa rregullatore për vitin 2025, për subjektin "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të kryhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Në të kundërt, ERE, në zbatim të nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, do të aplikojë ndaj të licencuarit masat administrative përkatëse, përfshirë gjobën deri në 3% të të ardhurave të vitit paraardhës dhe kamatëvonesën në masën 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesë.

- Mbështetur në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", sipas të cilit një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi publik që e ka nxjerrë, vlerësohet e nevojshme ndërhyrja në vendimin nr. 112, datë 23.5.2025, për të reflektuar shtimin e subjektit "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., në tabelën nr. IV të atij vendimi dhe për të përshtatur përmbajtjen e pikës 2 të dispozitivit, me qëllim përfshirjen e diferencave që rrjedhin nga ky përditësim në përllogaritjen e pagesave të periudhës pasardhëse.

- Si rrjedhojë, pika 2, e vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, vlerësohet të riformulohet si më poshtë: "Diferencat në vlerë që do të rezultojnë nga përllogaritja e pagesës rregullatore sipas këtij vendimi, për të gjitha shoqëritë e licencuara të cilat janë subjekt të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, "Mbi përllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025" (sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi), do të korrigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse".

- Ndryshimet e parashikuara në këtë vendim kufizohen vetëm në përfshirjen e subjektit "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., në tabelën IV, të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, si dhe në ndryshimin përkatës të pikës 2 të po këtij vendimi. Dispozitat e tjera të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, mbeten në fuqi dhe zbatohen pa ndryshime për të gjitha subjektet e tjera të licencuara të përfshira në atë vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në tabelën IV, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, shtohet subjekti "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me NIPT L41811003F, me pagesë rregullatore për vitin 2025 në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, ndryshon dhe bëhet: "Diferencat në vlerë që do të rezultojnë nga përllogaritja e pagesës rregullatore sipas këtij vendimi, për të gjitha shoqëritë e licencuara të cilat janë subjekt të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, "Mbi përllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025" (sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi), do të korrigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti